

Mundësi për aplikim të bashkive në programin e trajnimit me grant të thirrjes “URBACT Pioneers Accelerator” nën Programin URBACT

Synimi i Thirrjes:

Kjo thirrje synon të krijojë një program trajnimi të përshtatur për fuqizimin e bashkive nga Ballkani Perëndimor – vendet përfituese të IPA-s – për të adresuar sfidat e zhvillimit urban të qëndrueshëm, duke promovuar bashkëpunimin dhe qasjen e integruar në politikat urbane. Programi synon të krijojë një brez profesionistësh në sektorin e zhvillimit urban që do të ndryshojnë të ardhmen e qyteteve të tyre përmes projekteve të bazuara në standardet dhe kuadrin politik të BE-së për zhvillim urban të qëndrueshëm. Rreth 20 qytete nga rajoni do të përzgjidhen për të marrë pjesë në këtë mundësi unike, duke krijuar një mjedis për shkëmbimin e njohurive midis qyteteve të Ballkanit Perëndimor dhe atyre të BE-së.

Çfarë ofron programi URBACT Pioneers Accelerator?

- **Rritje e Kapaciteteve dhe Aftësive:** Zhvillimi i aftësive praktike në planifikimin urban, angazhimin e palëve të interesuara, analizën e të dhënave dhe komunikimin strategjik, për të ndihmuar qytetet të përballen me sfida komplekse urbane.
- **Krijimi i Roadmap për Projekte të Ardhshme:** Përgatitja e planeve dhe strategjive që udhëheqin iniciativat e ardhshme, duke siguruar përputhjen me kuadrin e zhvillimit rajonal të BE-së dhe objektivat globale të qëndrueshmërisë.
- **Mësim mes Kolegësh dhe Mundësi për Rrjetëzim:** Lidhje të forta me qytete të tjera dhe krijimin e një rrjeti mbështetës për mësim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm përtej programit.
- **Praktika suksese të Dokumentuara dhe Rritje e Vizibilitetit të Qytetit:** Zbatimi i projekteve pilot me ndikim (zgjidhje të qëndrueshme) që shfaqin arritjet e qytetit dhe frymëzojnë përsëritjen e tyre në qarqe të tjera, duke ndihmuar në përthithjen e fondeve dhe partneriteteve.
- **Integrim në Komunitetin URBACT:** Qasje e zgjeruar në burime, ekspertizë dhe mundësi për bashkëpunime të ardhshme brenda rrjetit më të gjerë URBACT dhe BE-së.

Tematika e programit URBACT Pioneers Accelerator:

- **Mobiliteti i Qëndrueshëm:** Përmirësimi i mobilitetit urban duke bërë transportin publik më efikas, duke inkurajuar çiklizmin dhe ecjen, si dhe reduktimin e varësisë nga makinat. Synohet krijimi i qyteteve më të pastra dhe më të lidhura, me më pak trafik dhe ndotje.
- **Menaxhimi i Mbetjeve:** Reduktimi, riciklimi dhe menaxhimi më efektiv i mbetjeve urbane. Fokusi është në krijimin e mjediseve më të pastra, promovimin e praktikave të ekonomisë qarkulluese dhe inkurajimin e sjelljes së përgjegjshme përmes iniciativave të drejtuara nga komuniteti dhe zgjidhjeve inovative.
- **Mjedisi Urban:** Mbrojtja, krijimi dhe përmirësimi i hapësirave të gjelbra brenda qyteteve. Synohet rritja e biodiversitetit, zgjerimi i mjediseve të gjelbërta dhe përmirësimi i hapësirave publike për t'i bërë zonat urbane më të jetueshme dhe më të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike.
- **Punësimi dhe Mbështetja për NVM-të:** Mbështetja e zhvillimit të bizneseve lokale, veçanërisht ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), për të forcuar ekonominë lokale. Fokusimi në krijimin e mundësive për sipërmarrje, rritjen e tregtisë lokale dhe ndërtimin e ekosistemeve ekonomike të qëndrueshme.
- **Zhvillimi i Turizmit të Qëndrueshëm:** Krijimi i strategjive turistike miqësore me mjedisin, të ndjeshme ndaj kulturës dhe ekonomikisht përfituese për qytetet.

Synohet përmirësimi i përvojave të vizitorëve duke ruajtur kulturën lokale dhe reduktuar ndikimin mjedisor të turizmit.

- **Kultura:** Shfrytëzimi i artit, trashëgimisë dhe aktiviteteve kulturore për të pasuruar jetën urbane, forcuar identitetin e komunitetit dhe stimuluar ekonominë lokale. Inkurajohet përdorimi i kulturës për të angazhuar banorët, të rinjtë dhe vizitorët në mënyrë kreative.

Temat ndër në Çdo Fokus::

- **Qëndrueshmëria mjedisore** (p.sh. cilësia e ajrit, energjia efiçente, hapësirat e gjelbra, etj.).
- **Gjithëpërfshirja sociale** (p.sh. gjinia, aftësitë ndryshe, mosha, etj.).
- **Dixhitalizimi** (p.sh. qytetet e zgjuara, shërbimet dixhitale për qytetarët, etj.).

Përfitimet për ekipet lokale gjatë 18 muajve të programit:

- Lidhja dhe mësimi prej komunitetit të ekspertëve urbanë të BE-së.
- Përvetësimi i njohurive të reja përmes mjeteve dhe metodologjive të URBACT.
- Përfshirja e aktorëve lokalë për të krijuar një ekosistem produktiv për zbatimin e suksesshëm të zgjidhjeve të qëndrueshme urbane (projekte pilot).

Format e trajnimit:

- Evente dhe workshop-e me pjesëmarrje fizike.
- Vizita në terren.
- Seminare online dhe seanca të personalizuar.

Tri dimensionet kryesore të programit të mësimi:

- **Përqafimi (Embrace):** Të gjithë bashkitë pjesëmarrëse do të përvetësojnë qasjet metodologjike bazë dhe mjetet e menaxhimit të projekteve. Trajnimet dhe praktikat e mira do të sigurojnë njohuri të përbashkëta për të gjithë pjesëmarrësit.
- **Eksplorimi (Explore):** Ky dimension do të përfshijë “Ekspeditat Tematike Urbane ” në qytete frymëzuese të BE-së, ku bashkitë pjesëmarrëse do të vizitojnë bashki të tjera, do të eksplorojnë zgjidhje të mundshme dhe do të mësojnë nga ekspertët e ndryshimit urban.
- **Veprimi (Act):** Ekipet lokale do të aplikojnë qasjen e "të mësuarit përmes veprimit" në kontekstin e tyre lokal, duke përfshirë aktorët kryesorë dhe duke zbatuar një projekt pilot konkret në terren, me ndërhyrje të dukshme dhe të qëndrueshme.

Kush është i pranueshëm për të aplikuar në thirrjen URBACT Pioneers Accelerator?

- Bashkitë nga shtetet e Ballkanit Përendimor dhe vendet përfituese të IPA-s;
- Qarqet;
- Agjencitë vendore ose organizata vendore ose gjysmë-publike të krijuara nga bashkitë.
- Institucione të përfaqësuara nga një organizatë politiko-administrative me kompetenca të deleguara për krijimin dhe zbatimin e politikave.

Rregulla shtesë për aplikimet e Bashkive:

- Bashkitë mund të dorëzojnë më shumë se një aplikim nëse departamente të ndryshme të tyre (Ekipet Lokale) adresojnë sfida urbane të ndryshme.
- Bashkitë që janë pjesë e rrjeteve ekzistuese të URBACT mund të aplikojnë vetëm në rastet kur përfshihet një departament tjetër (Ekip Lokale) nga ai që është aktualisht i angazhuar.

Buxheti:

Buxheti total për çdo bashki të përzgjedhur: **35,000 EUR**.

Shpërndarja e buxhetit:

- Rreth **10,000 EUR** për pjesëmarrjen në evente fizike, duke përfshirë udhëtimin dhe akomodimin për ekipin lokal.
- Rreth **15,000 EUR** për organizimin e aktiviteteve lokale (takime të ekipeve lokale, Action Labs) dhe zbatimin e projektit pilot me përmasa të vogla.
- Rreth **10,000 EUR** për kostot e stafit të brendshëm, duke përfshirë pagën e praktikantëve të URBACT gjatë gjithë programit.

Bashkëfinancimi:

- 95% e buxhetit mbulohet nga Fondet IPA.
- 5% e mbetur duhet të bashkëfinancohet nga buxheti i bashkisë lokale.

Mënyra e Aplikimit:

Forma e aplikimit:

- Aplikimi duhet të bëhet online dhe në anglisht.
- Modeli i formularit të aplikimit dhe pyetësorit (Annex 3) është i bashkangjitur në thirrje.
- Një Letër Angazhimi e firmosur nga Kryetari i Bashkisë duhet të bashkëngjitet në formularin e aplikimit.

Afati i fundit për aplikim:

- 22 janar 2025, ora 15:00 CET.

Linku i Thirrjes:

<https://urbact.eu/get-involved>